

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 23 QERSHOR 2022

Ju shkruani Rregulloren e Parlamentit. Ju kryeni krim, sepse shkelni ligjin e parlamentit, ku përcaktohet qartë qëndrimi që mbahet ndaj rezolutave. Sipas këtij ligji, rezoluta, brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit, shqyrtohet në kryesinë e parlamentit. Rezoluta për gjenocidin dhe krimet e barbarëve serbë në Kosovë ka 3 javë që pret të shqyrtohet. Zonjë, parlamenti nuk është dyqani yt, parlamenti është krejt tjetër. Ti nuk ke konceptet më elementare.

Në fund thuhet se filan deputet tha: “Këtë rezolutë do ta dërgojmë në Komisionin e Jashtëm”, por ligji i parlamentit nuk e parashikon një gjë të tillë. Ligji i parlamentit parashikon që nga kryesia e parlamentit, çështja vjen në sallën e parlamentit, ku bëhet një diskutim pro dhe një kundër, pastaj vendoset.

Ju, zonjë, po e trajtoni parlamentin në mënyrën më primitive, po e trajtoni parlamentin në mënyrën më të padenjë, po e trajtoni parlamentin sipas urdhrave që merrni nga Edi Rama. Ju vetëm po e rrisni shkallën e konfliktualitetit në parlament dhe e bëni parlamentin disfunksional. Nuk ka askush të drejtë të shkelë të drejtat e deputetëve në këtë parlament. Pse ju djeg juve dënimi i gjenocidit serb në Kosovë?